



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE PER INVESTIMET E HUAJA,
VENDASE DIHE INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 6185 Prot.

Fier, më 23.05. 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. 44, Datë 23.05 2025

PËR

**“ MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT STRATEGJIK ME TITULL
“CIRCLE” NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III,
PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027” SI
EDHE IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT “BLUENEW” NE KUADER TE
INSTRUMENTIT TE PARAANETARESIMIT INTERREG IPA ADRION 2021-2027**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, “, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin strategjik me titull “**CIRCLE**”, në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, si edhe projektit “**BLUNEW**” ne kuader te Programit INTERREG IPA ADRION 2021-2027

PROPOZOJ:

1. Miratimin për implementimin e projekteve me titull “**CIRCLE**” dhe “**BLUNEW**”, në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, financiar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi -Republika e Shqipërisë, 2021-2027 si edhe ne kuader te Programit INTERREG IPA ADRION 2021-2027

2. Bashkia Fier, si partner në këto dy projekte, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet. Buxheti për Bashkinë Fier është për projektin “CIRCLE” **389.591,20 euro** nga të cilat: **311.672,96 Euro** Kontribut i BE dhe **77.918,24 Euro** bashkëfinancim i Bashkisë Fier ndërsa për projektin “BLUNEW” është : **99.753,46 Euro** nga të cilat **84.790.44 Euro** Kontribut i BE dhe **14.963.02 Euro** bashkëfinancim i Bashkisë Fier
3. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier, të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecimin e projektit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Drejtoria e Hartimit të Projekteve për Investimet e Huaja,

Drejtoria Juridike

Vendase dhe Integritetit Europian

Esmeralda Kapllanaj

Haxhi Aqulla

Drejtoria e Finances ,Buxhetit dhe Konatbilitetit

Pranvera Çina

K R Y E T A R

ARMANDO SUBASHI

NE MUNGESË DHE ME URDHER

Sekretar i Përgjithshëm

MARTIN DODI

